



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Shkurt 2021

Nr: 100

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE
PËR QARKUN E TIRANËS DHE GJIROKASTRËS**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, si dhe në përmbushje të detyrimit administrativ për njoftimin e palëve, ka bërë njoftim publik për pjesëmarrje në këtë procedurë për të gjithë aplikantët të cilët shfaqën interes për të qenë monitorues për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Ky njoftim publik është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit.

Pas njoftimit publik, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zbatim të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, kanë depozituar dokumentacionin 79 (shtatëdhjetë e nëntë) aplikant të interesuar për monitorues.

Komisioni i Posaçëm i ngritur për verifikimin e plotësisë të kriterëve formale të aplikantëve për monitorues dhe procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar shqyrtoi të gjitha aplikimet e depozituara dhe në bazë të vlerësimit të nevojave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përzgjodhi listën prej 64 (gjashtëdhjetë e katër) monitoruesish duke përjashtuar 15 aplikantë për mosdorëzim të të gjithë dokumentacionit të kërkuar si dhe për mosparaqitje në intervistë.



Të 64 (gjashtëdhjetë e katër) aplikantët plotësojnë kriteret e përcaktuara të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”.

Për sa më sipër shorti për emërimin e monitoruesve u organizua për qarkun Tiranë dhe Gjirokastrë pasi pjesëmarrja më e lartë e aplikantëve ishte nga këto 2 (dy) qarqe, duke marrë pjesë 45 (dyzet e pesë) monitorues për qarkun e Tiranës dhe 5 (pesë) monitorues për qarkun e Gjirokastrës. Përsa i përket qarqeve të tjera, duke qenë se pjesëmarrja ka qenë më e ulët sesa numri për monitorues që duhet për secilin qark, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do nxjerri një njoftim të dytë lidhur me pjesëmarrjen që nevojitet për secilin qark për të plotësuar vakancat e mbetura.

Më datë 23.02.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin për përzgjedhjen e monitoruesve për qarkun Tiranë dhe Gjirokastrë.

Në një enë transparente u futën 45 (dyzetë e e pesë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e monitoruesve pjesëmarrës nga Tirana për qarkun Tiranë, nga të cilët u përzgjedhën 16 (gjashtëmbëdhjetë) monitorues. Në enën tjetër u futën 5 (pesë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 5 (pesë) monitoruesve pjesëmarrës nga Gjirokastra për qarkun Gjirokastrë, nga të cilët u përzgjedhën 2 (dy) monitorues.

PËR KËTO ARSYE

Referuar nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”

V E N D O S I

1. Të miratoj listën e monitoruesve për qarkun Tiranë, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:

- 1) Ditjon Murati
- 2) Gladiola Koka
- 3) Barsela Hyso
- 4) Klajvi Tenolli
- 5) Merita Curo



- 6) Joana Draci
- 7) Klajdi Pulaj
- 8) Isilda Kumurija
- 9) Florjan Çuni
- 10) Arban Muça
- 11) Ergys Xibinaku
- 12) Brikena Koçi
- 13) Grid Tahiraj
- 14) Ina Bufi
- 15) Leonard Bardhi
- 16) Suela Selmani

2. Të miratoj listën e monitoruesve për qarkun Gjirokastrë, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
 - 1) Rezarta Gozhita
 - 2) Gëzim Shehu
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

